



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 8 nëntor 2021
Nr. ref.:RK 1891/21

VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS
në

rastin nr. KI156/21

Parashtrues

Sylhane Sahitit

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës
Supreme të Kosovës Rev. nr. 185/2020, të 24 qershorit 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Sylhane Sahitit (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës) e përfaqësuar nga Jahir Bejta.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 185/2020, të 24 qershorit 2020.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të kontestuar përmes të cilit pretendohet se parashtrueses së kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë të garantuara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshëm], nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejte i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe nenin 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (ne tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ) dhe nenin 15 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (ne tekstin e mëtejme: DUDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 7, të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
5. Përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës, ashtu si në rastin KI30/21 ka kërkuar kthim në gjendje të mëparshme sa i përket afatit për paraqitjen e kërkesës në Gjykatë, në pajtim me nenin 50 (Kthimi në gjendjen e mëparshme) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, duke theksuar se *“pengesat e natyrës objektive për ushtrimin e kërkesës për vlerësimin e kushtetutshmërisë kanë qenë prezente nga 9 marsi 2020 deri me 1 janar 2021”*. Përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës i referohet faktit që objekti ky ai ka vepruar, është liruar për nevoja të sëmuarve me COVID-19, dhe është bërë bartja e dokumentacionit në një vend tjetër.

Procedura në Gjykatë

6. Më 27 gusht 2021, përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 1 shtator 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetarja caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha.
8. Më 9 shtator 2021, Gjykata kërkoi nga përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës që (i) të bashkëngjisë autorizimin që dëshmon se e përfaqëson parashtruesen e

kërkesës dhe (ii) të bashkëngjitë dokumentacionin mbështetës lidhur me rastin.

9. Më 21 shtator 2021, përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës, bashkëngjiti një autorizim dhe bashkëngjiti dokumentacionin mbështetës, përkatësisht vendimet e gjykatave të rregullta.
10. Më 21 tetor 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që të refuzojë kërkesën me procedurë të shkurtër.

Përmbledhja e fakteve

11. Faktet lidhur me këtë rast janë trajtuar në rastin KI30/21 (shih rastin e Gjykatës KI30/21, parashtruese *Sylhane Sahiti*, Aktvendim për Papranueshmëri i 28 korrikut 2021). Gjykata e kishte shpallur kërkesën KI30/21 si të pasafatshme.
12. Përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës kishte kërkuar kthimin në gjendje të mëparshme në rastin KI30/21, me arsyetimin se për shkak të pasojave të pandemisë, ai nuk ka mundur të parashtrojë kërkesën në kohë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

13. Parashtruesja e kërkesës përsëritë pretendimet e saj si në rastin KI30/21. Përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës poashtu ka kërkuar kthimin në gjendjen e mëparshme duke iu referuar disa ngjarjeve, dhe duke bashkëngjitur fotografi, të cilat sipas tij, tregojnë që ai nuk ka mundur të parashtrojë kërkesën në kohë.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

14. Gjykata fillimisht shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
15. Në këtë drejtim, Gjykata iu referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

16. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata u referohet neneve 47 (Kërkesa individuale) dhe 48 (Saktësimi i kërkesës) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.”
[...]*

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

17. Gjykata rikujton se kërkesa pranë nesh është përsëritje e kërkesës KI30/21, me pretendime plotësisht identike, me të vetmin dallim që në rastin pranë nesh në kërkesën për kthimin në gjendje të mëparshme përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës shton arsyetimin lidhur me mosparaqitjen në kohë të kërkesës KI30/21.
18. Në këtë aspekt, Gjykata i referohet paragrafit (5) të rregullit 35 (Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës) të Rregullores së punës, i cili përcakton si në vijim:

Rregulli 35
(Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës)

[...]
*“(5) Gjykata mund të vendosë të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se kërkesa është e paplotë ose e paqartë përkundër kërkesave të Gjykatës ndaj palës që të plotësojnë apo qartësojnë kërkesën, nëse kërkesa është përsëritje e një kërkesë të mëparshme të vendosur nga Gjykata, ose në qoftë se kërkesa është joserioze”
[...]*

19. Fillimisht, Gjykata thekson se bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJENDJ), në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, në mënyrë që Gjykata të shqyrtojë një kërkesë që ndërlidhet me të njëjtat fakte dhe pretendime sikurse kërkesat e mëparshme, parashtruesi duhet që të ofrojë informata të reja që më parë nuk janë shqyrtuar nga Gjykata (Shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së, *Kafkaris kundër Qipros*, ankesë nr. 9644/09, Vendim për papranueshmëri, i 21 qershorit 2011, paragrafi 68).

20. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës, ka paraqitur vendimet e njëjta gjyqësore, dhe ka pretendimet e njëjta si në rastin KI30/21. Përkundër faktit që përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës në rastin pranë nesh, shton argumentimin në kërkesën e tij për rikthimin e gjendjes së mëparshme lidhur me mos-paraqitjen e kërkesës KI30/21, Gjykata të njëjtin pretendim, nuk mund ta pranojë sepse vlerësimin e kërkesës për rikthimin në gjendjen e mëparshme e kishte bërë në rastin KI30/21, dhe në atë kërkesë kishte konstatuar se nuk i plotëson kushtet sipas nenit 50 të Ligjit.
21. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se vendimet e saj janë të formës së prerë dhe të detyrueshme për gjyqësorin, për të gjithë personat dhe për të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës (Shih Gjykata Kushtetuese, rasti nr. KI26/14, parashtrues *Bajrush Gashi*, Vendim i 26 marsit 2015, paragrafët 26-27; dhe po ashtu shih, rastin nr. KI105/16, parashtrues *Feti Gashi*, Vendim për refuzim i 10 majit 2017, paragrafi 22).
22. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtrueses së kërkesës, nuk i përmbush kriteret procedurale për shqyrtim të mëtejme, për shkak se është përsëritje e kërkesës së mëparshme KI30/21. Përfundimisht, në përputhje me rregullin 35 (5) të Rregullores së punës, kërkesa duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 47 e 48 të Ligjit dhe rregullin 35 (5) të Rregullores së punës, më 21 tetor 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË REFUZOJË kërkesën;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Remzije Istrefi-Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani